

VENDIM
Nr. 105, datë 22.4.2021

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SHA, PËR
RINOVIMIN E LICENCËS NR. 343, SERIA F16, PËR FURNIZIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “ç” dhe nenit 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “f”; të nenit 5, pika 1, germa “f”; të nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 47/7, datë 14.4.2021, mbi kërkesën e shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 540 prot., 9.4.2021, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, për rinovimin e licencës, sipas aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”. Po ashtu ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., në fazën e fillimit të procedurës, në bazë të nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton kryesisht i plotësuar, si më poshtë:

- Delegimi i të drejtave të aplikuesit (neni 7, pika 2, germa “a”). Plotësuar;
- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”). Plotësuar;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, “a”, “b”, “c”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte. Plotësuar;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, “a”, “b”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte. Plotësuar;
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike (neni 4.7, germat: “a”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”). Plotësuar.
- Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:
 - Nenin 7, “Delegimi i të drejtave të aplikuesit”, pika 2:
 - germa “b”, vërtetim që përfaqësuesi dhe i përfaqësuari nuk janë të përfshirë në një proces të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata).

Dokumentet juridike, administrative dhe pronësore:

Neni 9, pika 2:

- germa “d” (vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata).

Neni 16, pika 1, germa “c”:

Dokumentet financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3:

- germa “c” (Dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.).

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike

Neni 9, pika 4.7:

- germa “b” (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj). Duke qenë se sa thënë nga shoqëria, mbetet në kuadrin e deklaratës, në vijim do t’i kërkohej të paraqesë në ERE vërtetim për gjendjen e llogarisë nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj, si dhe kapitalin financiar të shprehur në vlera monetare që do të verë në dispozicion të kësaj veprimtarie.

Shoqëria do të njoftohet, që në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 343, seria F16, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti